


# Mësuesi dhe shkolla aktorët kryesorë në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.



**Ndërveprimi mësues - nxënës  
ndihmon në krijimin e klimës  
pozitive në shkollë**

“ “  
Një libër, një laps,  
një fëmijë dhe një  
mësues mund të  
ndryshojnë botën

*Malala Yousafzai*





## Roli i Mësuesit në Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm



Krijimi i një fryme pozitive në klasë, zvogëlon mundësinë e sjelljeve antishoqërore dhe te dhunshme.




Shkolla ka një rol shumë të rëndësishëm në përballimin e problematikave dhe sfidave të sotme shoqërore.

Shkolla duhet të identifikojë, ndër të tjera, faktorët që krijojnë kushtet që çënojnë vlerat demokratike dhe sigurinë e fëmijëve. Shkolla duhet të vlerësojë diversitetin kulturor, botëkuptimor, shoqëror, etnik etj., por duke u kujdesur që këto vlera, të mos krijojnë kushte për dukuri ekstremiste.

Nëse stafi arsimor dhe mbështetës, gjatë procesit mësimor-edukativ, vëren ndonjëren apo disa nga shenjat e përmendura më poshtë, ai/ajo duhet të zbatojë procedurat e ndërhyrjes. Veprimi i duhur dhe në kohë të duhur është më se i nevojshëm për trajtimin e rasteve në mënyrë të dobishme, para se ato të përshkallëzohen drejt ekstremizmit. Sa më i hershëm të jetë identifikimi i rasteve problematike, aq më i lehtë do të jetë menaxhimi i tyre .

### Fazat e radikalizmit

- a) Para-radikalizimi: individë/fëmijë që janë pasivë ndaj linjave të besimit/politikës/ideologjisë që mbështetin, dhe në përgjithësi nuk shfaqin asnjë shenjë mbështetëse ndaj dhunës. Në këtë fazë evidentohet interesi i shtuar për kontekstin politik/etnik/fetar/historik etj.;
- b) Identifikimi: në këtë fazë nxënësit orientohen drejt ideologjive që mbështetin dhunën, pavarësisht se janë pasivë në veprime;
- c) Indoktrinimi: në këtë fazë individët/fëmijët kalojnë nga pasivë në aktivë duke mbështetur dhe përkrahur akte terroriste të kryer nga organizata terroriste apo nga individë të veçantë;
- d) Veprimi: në këtë fazë individët/fëmijët jo vetëm mbështetin dhunën, por edhe ushtojnë dhunë tek të tjerët nën ndikimin e ideologjisë së tyre.



## Bashkëpunimi Mësues – Prind

*Nëse ju si mësues jeni të shqetësuar për një nxënës, i cili mund të jetë i radikalizuar, ju duhet të ndiqni standardet e shkollës, si për çështje të tjera problematike. Së bashku mund të diskutoni shqetësimin tuaj me prindërit e nxënësit. Në rast se e shihni të nevojshme duhet të kërkonti ndihmën e bordit të prindërve ku mund të diskutoni rreth situatës, duke ofruar zgjidhje të mundshme.*

## Faktorët që nxisin Ekstremizmin e Dhunshëm në shkollë.


Janë një sërë faktorësh "shtytës" dhe "tërheqës" që nxisin ekstremizmin e dhunshëm, të cilët nuk duhen neglizhuar nga stafi arsimor i shkollës.

- \* Faktorët ekonomikë dhe shoqërorë në familje dhe komunitet;
- \* Margjinalizimi, pabarazia dhe diskriminimi;
- \* Bullizmi në shkollë, familje apo komunitet;
- \* Ekzistenca e individëve dhe grupeve të mirëorganizuar të ekstremizmit të dhunshëm me ligjërime imponuese dhe programe efektive;
- \* Mundësi të vakta për përfshirje në jetën shoqërore;
- \* Mungesa e edukimit të përgjithshëm dhe edukimit fetar;
- \* Ofrimi i shërbimeve, të ardhurave dhe/ose punësimi në këmbim të rekrutimit/anëtarësimit;
- \* Ofrimi i premtimeve për anëtarët e rinj duke iu ofruar zgjidhje për problemet e tyre dhe duke iu premtuar aventurë dhe liri;
- \* Ofrimi i "ndjenjës së përkatësisë" dhe një rrjeti mbështetës shoqëror;
- \* Interesa të caktuara politike, të cilat promovojnë ekstremizmin, radikalizmin, terrorizmin dhe në përgjithësi dhunën për arritjen e qëllimeve të tyre;
- \* Radikalizimi online nëpërmjet rrjeteve të ndryshme sociale ;

## Veprimet që merr Mësuesi për Identifikimin:

### *Raportim dhe ngritje e grupit të punës*

- Mësuesi koordinator
- Oficeri i sigurisë në shkollë
- Psikologu i shkollës
- Bordi i prindërve



## Plani Individual

- Në fazën e parë, ngrihet grupi i përkohshëm i punës brenda shkollës me përfshirjen e mësuesit kujdestar, drejtorit të shkollës, oficerit të sigurisë në shkollë, mësuesit të lëndës që përcakton rastin, psikologut të shkollës dhe prindit të nxënësit. Ky grup fillon punën me analizimin e sjelljeve të nxënësit e më tej me hartimin e një plani të përbashkët për rehabilitim me qasje kurrikulare dhe ekstra-kurrikulare.

Pra, fillimisht rasti shqyrtohet dhe trajtohet në shkollë, e më pas, nëse nxënësi nuk arrin të menaxhohet nga shkolla referohet nga drejtori i shkollës tek Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar dhe tek Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve ose tek Këshilli Vendor i Sigurisë Publike.

### ***Për menaxhimin dhe trajtimin të dobishëm të rastit grupi i punës ka parasysh ndër të tjera:***

- Me kë po shoqërohet dhe sa lidhje të forta kanë?
- A ka ndonjë ndryshim të madh në moshë mes tyre?
- Si po e kalojnë kohën ata?
- A duket sikur kjo marrëdhënie është e pashëndetshme?  
(A ka bullizëm apo përfitime në këtë marrëdhënie)?
- A ka ndryshuar marrëdhënia e tyre gjatë kësaj kohe?  
(A kanë humbur miq të vjetër apo kanë gjetur të rinj)?
- A qëndrojnë veçmas nga të tjerët gjatë pushimit?

- Në kohën e lirë, a qëndron i mënjanuar nxënësi?
- A shkaktojnë probleme në klasë apo janë të tërhequr?
- A shfaqin mendësi ekstreme gjatë diskutimeve që zhvillohen në klasë?
- A ka pasur raste që janë përfshirë në bullizëm, apo sulme ndaj të tjerëve për shkak të fesë, ideologjisë apo politikës?
- Cili është qëndrimi i tyre dhe sa janë të hapur për të diskutuar çështje që i përkasin sjelljes së tyre?
- A janë shkëputur nga veprimtaritë në shkollë?
- A janë shkëputur nga veprimtaritë shoqërore?
- A kanë pasur rënie në mësimet?
- A kanë pasur mungesa të shpeshta?
- A ka shenja që tregojnë se ata duan të vetëpërgjigjen nga shkolla?

## Trajtimi i nxënësit në shkollë

Para se nxënësi të referohet tek struktura të tjera në komunitet, shkolla ka si detyrim trajtimin e nxënësit bazuar në një program individual me qasje kurrikulare dhe ekstra-kurrikulare gjithëpërfshirëse. Në këtë plan evidentohen qartësisht detyrat dhe përgjegjësitë e secilit aktor të angazhuar për trajtim si me poshtë :

- **Mësuesi koordinator për ndjekjen e Planit të Veprimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm** është pjesë e grupit të punës (të përkohshëm) për hartimin e planit individual për nxënësit si edhe për trajtimin dhe informimin e koordinatorit në zyrën vendore arsimore për ecurinë e rastit. Gjithashtu, mësuesi koordinator bëhet pjesë e Grupit Teknik Ndërinstitucional nëse rasti referohet tek institucione të tjera në komunitet;
- **Mësuesi kujdestar i klasës**- është ai që koordinon punën për rehabilitimin e nxënësit si edhe përgatit klasën për krijimin e një mjedisi të qetë, pozitiv dhe gjithëpërfshirës për trajtimin me qasje kurrikulare dhe ekstra-kurrikulare në sajë të zbatimit të projektit “Shkolla si qendër komunitare” , por jo vetëm. Po ndërkohë, ai është i detyruar të mbajë marrëdhënie të mira me prindërit e nxënësve të klasës duke i informuar rregullisht ata rreth mbarëvajtjes së fëmijëve të tyre, vecanërisht duke takuar me përparësi prindërit e nxënësve me vështirësi në të nxënë, me sjellje shqetësuese ose me probleme në ndjekjen e shkollës;

- **Psikologu/ punonjësi social** - bashkëpunon me mësuesit dhe prindërit, identifikon e vlerëson, sa më herët të jetë e mundur, nxënësit me probleme të sjelljes ose me vështirësi në të nxënë, dhe harton e zbaton për këta nxënës plane të veçanta parandaluese ose rehabilituese.

- **Ndihmon** punonjësit arsimorë, prindërit dhe nxënësit në parandalimin ose eliminimin e abuzimeve të punonjësve arsimorë ndaj nxënësve, të nxënësve ndaj nxënësve si dhe abuzimeve të vetë nxënësve me duhanin, alkoolin, drogat etj.
- **Informon**, nëpërmjet bisedave e leksioneve, punonjësit e institucioneve arsimore për zhvillimet tipike të moshës së nxënësve dhe problemet tipike që nxënësit hasin gjatë të mësuarit dhe të nxënës.
- **Ndihmon** mësuesit kujdestarë dhe mësuesit lëndorë për integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në klasat e institucioneve arsimore të zakonshme.
- **Plotëson dosjet individuale** për rastet e nxënësve që kanë përfutuar nga shërbimi psiko-social.
- **Raporton** me shkrim tek drejtuesi i njësisë së shërbimit psiko-social çdo fakt për abuzim të nxënësve nga punonjës arsimorë dhe prindër të nxënës.

- **Oficeri i Sigurisë në Shkollë**- monitoron mjedisin e shkollës në mënyrë të vazhdueshme, rreth situatave të dyshimta, hyrjes së personave të paautorizuar apo cenimit të pronës së shkollës, duke punuar me shkollat për përmirësimin e nivelit të ndërgjegjësimit për problematika si përdorimi i drogës, bullizmi, siguria në internet, shfaqjet e dhunës dhe krimet etj.

### **Burime ku mund të merrni informacion më të detajuar për funksionin e Mekanizmit të Mbrojtjes së Fëmijëve:**

1. LIGJ Nr. 18/2017: “PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS”
2. VENDIM Nr. 353, datë 12.6.2018: “PËR RREGULLAT E FUNKSIONIMIT TË GRUPIT TEKNIK, NDËRSEKTORIAL PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE, PRANË BASHKIVE DHE NJËSIVE ADMINISTRATIVE”
3. VENDIM Nr. 578, datë 3.10.2018: “PËR PROCEDURAT E REFERIMIT E TË MENAXHIMIT TË RASTIT, HARTIMIN DHE PËRMBAJTJEN E PLANIT INDIVIDUAL TË MBROJTJES, FINANCIMIN E SHPENZIMEVE PËR ZBATIMIN E TIJ, SI DHE ZBATIMIN E MASAVE TË MBROJTJES “



Ky material është botuar në  
kuadër të projektit  
“Parandalimi i radikalizmit dhe ekstremizmit  
të dhunshëm në shkolla dhe komunitete si mjet për  
garantimin e të drejtave të fëmijëve”,  
i financuar/mbështetur nga **UNICEF** dhe zbatuar nga  
**Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm,**  
**Ministria e Arsimit Rinisë dhe Sporteve dhe Save the Children.**

@Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej specialistëve të fushës, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim të shoqërohet me njohjen e organizatave, të përmendura më lart, si burim.

Këndvështrimet e autorëve të këtij botimi jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Save the Children dhe UNICEF.



Tiranë, 2020